

**VENDIM**  
**Nr. 247, datë 20.3.2015**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**PËR PERIUDHËN 2015-2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE**  
**KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**2015-2020**  
**Mars 2015**

**LISTA E SHKURTIMEVE**

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADISA	Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKKP	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AP	Avokati i Popullit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AQTN	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AKT	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DAETIK	Departamenti për Agjendën Evropiane Digjitale dhe Teknologjinë e Informacionit
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPM	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rugor

DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
IQ	Inspektorati Qendror
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IQT	Inspektorati Qendror Teknik
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KQZ	Komiteti Qendror i Zgjedhjeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MD	Ministria e Drejtësisë
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
MIAP	Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike
MK	Ministria e Kulturës
MMB	Ministria e Mbrojtjes
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHCV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
PP	Prokuroria e Përgjithshme
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike
ZPKR	Zyra e Prokurorisë për Krimet e Rënda
ZRPP	Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme

## Hyrja

Korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve. Në vitin 2013, Shqipëria shënoi sërish për të tretin vit radhazi vendin e fundit, nga vendet e rajonit në renditjen e indeksit global të perceptimit të korrupsionit duke marrë kështu damkën si vendi më i korruptuar në Evropë. Ulje – ngritjet e perceptimit publik në 10 vitet e fundit, objektivisht, përkojnë me reformat e kryera ose të munguara të qeverisjes. Për këtë arsye, qeveria e konsideron perceptimin e publikut mbi korrupsionin jo vetëm si tregues për gjendjen reale të tij (të korrupsionit), por edhe si masë për suksesin apo dështimin e politikave dhe programeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit.

Përkundrejt këtij sfondi faktesh dhe kësaj vetëdije politike e shoqërore, me objektivin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, qeveria angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton.

Përparësia e qeverisë në këtë fushë, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritimit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Në përgjigje të nevojave të vendit për zhvillim dhe pritshmërive të ligjshme të publikut dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, qeveria synon të ndërmarrë një përpjekje në luftën kundër korrupsionit, e cila të përfshijë një qasje të trefishtë parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese. Ky dokument ka për qëllim të përcaktojë objektivat dhe drejtimet kryesore të politikave, të cilat do të udhëheqin planin e veprimit të qeverisë për luftën kundër korrupsionit në 3 vitet e ardhshme.

Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuar në këtë dokument janë në linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe rekomandimet e KE-së për Shqipërinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

## METODOLOGJIA DHE PROCESI I HARTIMIT

Metodologjia bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Hartimi dhe zhvillimi i strategjisë dhe planit të veprimit që e shoqëron atë, ka kaluar nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, përfshi këtu institucione të administratës shtetërore dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit. Dokumenti strategjik është hartuar në bazë të eksperiencave dhe nga të gjitha institucionet kombëtare që kanë pasur një rol për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Luftën kundër Korrupsionit dhe për një Qeverisje Transparente 2008-2013 dhe Planin e Veprimit që e shoqëroi Strategjinë. Gjithashtu, ai u bazua në rekomandimet e Projektit kundër Korrupsionit në Shqipëri (Projekti PACA) që u realizua deri në vitin 2012, me asistencën e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Strategjia, në zbatim të akteve nënligjore është e bazuar mbi statistika të disponueshme, vlerësime të projekteve të ndryshme, monitorime të strategjisë së mëparshme, raporte progresi të BE-së, udhërrëfyesit për 5 prioritetet për integrimin evropian dhe në përmbushje dhe përputhje të plotë me objektivat e Qeverisë për arritjen e standardeve të nevojshme, në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Rekomandimet e dala nga projekti i Bashkimit Evropian për Vlerësimin e Kuadrit Antikorrupsion në Shqipëri (ACFA) janë pasqyruar si në përmbajtjen e Strategjisë ashtu dhe në formulimin e masave specifike në Planin e Veprimit.

Procesi i vlerësimit ka filluar në dhjetor 2013, duke vijuar më tej me konsultime dhe hartimin e draftit të parë të strategjisë në mars 2014, i cili u hartua me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Në periudhën mars-gusht 2014 është hartuar, gjithashtu, me asistencën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, dhe kontributin e institucioneve të pavarura dhe qendrore, drafti i parë i Planit të Veprimit që shoqëron Strategjinë. Masat e sugjeruara nga institucionet janë hartuar në bazë të prioriteteve të qeverisë, të buxhetit që i është alokuar çdo institucioni, si dhe në bazë të sugjerimeve të ekspertëve nga çdo institucion. Dokumentet i janë dërguar DPZHNH-së dhe pas marrjes së komenteve në dhjetor 2014, është hartuar drafti i dytë i rishikuar, i cili i është komunikuar institucioneve për komente dhe plotësime.

Hartimi i këtyre dy dokumente politikash janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me rrjetin e koordinatorëve dhe pikave të kontaktit që Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit ka në institucionet qendrore, të pavarura dhe në nivelin lokal.

Plani i veprimit që i referohet periudhës 2015-2017 i bashkëngjitet kësaj strategjie si aneks 1.

## KAPITULLI I


### KUSHTET AKTUALE

#### Vështrim i përgjithshëm

Korrupsioni dhe luftimi i tij vijnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë. Gjatë viteve 2007-2010, reformat e ndërmarra nga qeveria kanë synuar modernizimin e administratës shtetërore dhe proceset e saj të punës, duke kontribuar kështu në parandalimin e korrupsionit në fusha ku korrupsioni ishte në nivele tepër të larta dhe ku ndikimi mbi ekonominë e vendit ishte i ndjeshëm. Kështu përmes reformave rregullatore në fushën e auditimit, krijimi i sistemit të prokurimit elektronik me qëllim rritjen e transparencës në fushën e prokurimeve

publike, u shënuar rritje e performancës së qeverisë në këto fusha, çka evidentohet edhe nga treguesit e përbërë të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.<sup>1</sup> Po kështu, krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, Qendrës Kombëtare të Licencimit të Bizneseve, si dhe ngritja e sistemeve të E-tatimeve dhe E-doganave, ka lehtësuar ndjeshëm procedurat administrative përkatëse dhe ka reduktuar kontaktet personale të përdoruesve/kërkuesve të shërbimit me administratën, si dhe ka kontribuar në uljen e nivelit të korrupsionit në këta sektorë.

Numri i çështjeve të dërguara në gjykatë në raport me numrin total të procedimeve<sup>2</sup>




<sup>1</sup> Shiko *Control of Corruption Index, World Bank* <http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>

<sup>2</sup> Statistikat e referuara janë të bazuara në statistikën e konsoliduar të grupit ndërinstitucional të punës, dhe në bazë të urdhrorit të Ministrisë të Drejtësisë nr. 8904/1, datë 12.12.2013 “Për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar”

Për sa i përket ndëshkimit të korrupsionit, arritjet kanë qenë të ndjeshme për arsye edhe të rishikimit të kuadrit ligjor që mundëson rritjen e efektivitetit të hetimeve. Ndryshimet kushtetuese për kufizimin e imuniteteve të deputetëve dhe gjyqtarëve hapën rrugën për goditjen penale të korrupsionit në nivelet e larta dhe luftimin e pandëshkueshmërisë. Këto ndryshime u shoqëruan, gjithashtu, me zbatimin e rekomandimeve për Shqipërinë, të raundit të dytë dhe të tretë të GRECO<sup>3</sup>, në lidhje me çështjet e imuniteteve, pastrimin e parave, si dhe me miratimin e legjislacionit për sa i përket financimit të partive politike dhe të fushatave elektorale. Megjithatë, pavarësisht miratimit dhe zbatimit të pjesshëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2008- 2013, treguesit e dy (2) viteve të fundit, sidomos në perceptimin e korrupsionit, kanë treguar përkeqësim të dukshëm. Më 2014-n, sipas Barometrit Global të Korrupsionit, 66% e grupit të pyetur mendonte që korrupsioni në vend ishte në rritje<sup>4</sup>. Fusha me nivel më të lartë korrupsioni sipas barometrit është drejtësia, ku procedimi dhe ndëshkueshmëria e korrupsionit mbetet ende problematike. Edhe pse janë ndërmarrë iniciativa gjatë viteve të fundit për ndëshkimin e korrupsionit, përfshi këtu krijimin e Njësive të Përbashkëta Hetimore, krijimin e njësive antikorrupsion në institucione ligjzbatuese etj., bashkëpunimi i agjencive ligjzbatuese për hetimin proaktiv të korrupsionit nuk ka pasur rezultate të ndjeshme për luftën kundër korrupsionit.

Numri i vendimeve në raport me numrin e dënimeve të dhëna nga gjykatat e rretheve gjyqësore



Në lidhje me ndërgjegjësimin mbi korrupsionin, vihet re ndërgjegjësimi në një masë të gjerë rreth problematikave të korrupsionit, të cilat perceptohen si prezente në shumë fusha të qeverisjes<sup>5</sup>. Në disa fusha, si drejtësia, shëndetësia dhe partitë politike, korrupsioni konstatohet të jetë në nivele alarmante, duke cenuar kështu edhe besueshmërinë ndaj institucioneve shtetërore.

Më tej, partnerë ndërkombëtarë kanë theksuar në raportet e tyre problematikat kryesore në këtë fushë, që shtrihen përtej perceptimit të korrupsionit dhe analizojnë problematikat konkrete të situatës. Më 2014-n, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka cituar në raportet e saj mungesën e ndëshkueshmërisë për situatën e korrupsionit. Nga ana tjetër, Raporti i Progresit i BE-së 2014, ka theksuar që Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet në luftën kundër korrupsionit, të forcojë bashkëpunimin ndërmjet agjencive ligjzbatuese dhe të eliminojë pengesat ndaj hetimeve proaktive. Gjithashtu, hetime rreth pasurisë së pajustificuar dhe korrupsionit duhet të jenë eficiente, duke përfshirë përdorimin efikas të hetimit financiar. Kjo do të çonte në kohë në ndërtimin e një historiku rezultatesh (*track record*) me ndjekje penale dhe dënime të formës së prerë në çështjet e korrupsionit.

Sipas raportit, dy fusha ku duhet të përqendrohen përpjekjet për të luftuar korrupsionin janë ato të shërbimeve tatimore dhe doganore ku duhet të rriten hetimet proaktive dhe të përmirësohet auditi i brendshëm dhe vlerësimi i riskut. Në kuadrin e menaxhimit të fondeve publike, konstatohet nevoja për nritjen e transparencës në procedurat e prokurimit publik, përfshi blerjet me vlerë të vogël, me qëllim që të reduktohet risku i korrupsionit dhe të përmirësohet konkurrenca<sup>6</sup>.

Gjithashtu, *Indicative Strategy Paper 2014-2020*,<sup>7</sup> rekomandon që Shqipëria duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse për krijimin e një kornize institucionale të fuqishme që parandalon korrupsionin, duke përmirësuar bashkëpunimin

<sup>3</sup> GRECO – Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (*Group of States against Corruption*)

<sup>4</sup> *Global Corruption Barometer 2013*, Transparency International ([http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=\\_albania](http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=_albania))

<sup>5</sup> *Global Corruption Barometer 2013*, Transparency International, [http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=\\_albania](http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=_albania)

<sup>6</sup> Raporti i Progresit i BE-së 2014

<sup>7</sup> *IPA II- Indicative strategy paper for Albania (2014- 2020)* e miratuar më 18.8.2014

ndërmjet agjencive dhe duke forcuar mekanizmat e brendshëm të kontrollit, verifikimin e deklaratave të pasurisë, dhe kontrollin mbi financimin e partive politike. Organizimi institucional duhet të forcohet ndjeshëm, si në aspektin e personelit dhe në drejtim të respektimit të pavarësisë së plotë të zbatimit të ligjit dhe të organeve gjyqësore që përfshihen në hetimet e rasteve të korrupsionit.

Sfidat

Sfidat e evidentuara në këtë dokument vijnë si rezultat i vlerësimeve të raporteve të Bashkimit Evropian, si dhe të vlerësimeve të ndryshme nga organizatat ndërkombëtare. Gjithashtu, prioritetet janë evidentuar bazuar në dokumente të asistencës teknike të ofruar nga projekti ACFA<sup>8</sup>.

Sfida të përgjithshme që lidhen me kuadrin e gjerë të antikorrupsionit vijnë të jenë fushat më poshtë:

- forcimi i integritetit të administratës publike;
  - reformimi i sistemit të drejtësisë dhe pavarësia e drejtësisë;
- nritja e cilësisë të legjislacionit;
- qëndrueshmëria e administratës publike;
  - mbështetja e pavarësisë dhe/ose autonominë funksionale të institucioneve kyçe (ligjzbatuese dhe të pavarura);
  - mungesa e besimit apo bashkëpunimit ndërinstitucional.

Duke marrë parasysh që reforma në drejtësi si dhe në administratën publike trajtohen specifiku në dokumentet përkatëse strategjike të qeverisë<sup>9</sup>, për të evituar përsëritjet dhe mbivendosjet, SNKK-ja i trajton sfidat më lart vetëm në kuadrin të objektivave specifike të SNKK-së.

Në kuadrin e parandalimit evidentohen sfidat më poshtë:

1. Transparenca në veprimtarinë shtetërore

Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore mundëson një kontroll më të plotë nga ana e publikut. Ndryshimet e fundit ligjore lidhur me të drejtën e informimit, përmes miratimit të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, përmirësojnë mundësitë e qytetarëve dhe subjekteve për kontrollin e veprimtarive shtetërore. Megjithatë, punë nevojitet ende lidhur me zbatimin

<sup>8</sup>ACFA-Anti Corruption Framework Assessment project, 2014 financuar nga Bashkimi Evropian

<sup>9</sup> Projekt-SNRAP dhe projektstrategjia e drejtësisë (ende në proces hartimi në kohën e miratimit të SNKK-së)

e plotë të ligjit, përfshi këtu përmes krijimit të strukturave apo përcaktimit të personave përgjegjës në institucione që do të sigurojnë zbatimin e ligjit, si dhe miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e plotë të ligjit.

Më tej, lidhur me transparencën në përdorimin e fondeve buxhetore, me ndryshimet ligjore e marsit 2014, ku Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave të tenderimit për koncesionet dhe partneritetet publike-private, si edhe miratimin e dispozitave që sqarojnë udhëzimet për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, mundësohet aksesimi më i mirë i qytetarëve në përdorimin e fondeve buxhetore. Por, ndryshimet në ligjin për koncesionet dhe partneritetet publike-private kërkojnë rritje të transparencës lidhur me koncesionet si fusha me rrezikshmëri të lartë për korrupsion pasi kërkojnë ngritjen e sistemeve të integruara për buxhetimin, menaxhimin financiar dhe prokurimin.

Ndërkohë, në fushën e prokurimit, duhet të vijojë procesi i monitorimit të proceseve të prokurimit, ndërsa nevojitet kontroll më i plotë lidhur me shkelje të mundshme gjatë proceseve të prokurimit, përfshi këtu rastet e konfliktit të interesave.

2. Parandalimi i konfliktit të interesave dhe deklarimi i pasurive në kuadër të forcimit të integritetit të nëpunësve publikë

Në maj 2014, u miratuan ndryshime në ligjet për deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit, duke shtuar numrin dhe shpeshësinë e kontrolleve të Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktin e Interesit (ILDKPKI) dhe duke detyruar deklarimin e vlerave në para në dorë mbi një vlerë të caktuar dhe duke kërkuar depozitimin e tyre në bankë. Dorëzimi i informacionit të rremë është bërë vepër penale, ndërsa pritjet edhe legjislacioni i ri lidhur me mbrojtjen e informatorëve të korrupsionit, si dhe ngritja e strukturave për zbatimin e këtij ligji.

Sfidë në këtë kuadër vijon të jetë bashkëpunimi i ILDKPKI-së me institucionet e tjera, pasi ILDKPKI-ja bazohet në bashkëpunimin e autoriteteve përgjegjëse dhe rolin e tyre kyç për të realizuar punën e tij. Rritja e kapaciteteve teknike të ILDKPKI-së, aksesimi në databaza shtetërore për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për hetimet administrative dhe rritja e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse mbeten ende sfida. Më tej, publikimi i deklarimeve të pasurive (në vijim të rekomandimeve të GREO-së dhe organizatave ndërkombëtare), si dhe kontrolli i pasurive të zyrtarëve të lartë mbeten prioritete.

3. Kontrolli i financimit të partive politike

Me gjithë progresin e sipërpërmendur, lidhur me kontrollin e financimit të partive politike, përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, në dispozitat ligjore, sidomos në Kodin Zgjedhor mbeten ende boshllëqe dhe probleme të evidentuara veçanërisht nga projekti ACFA. Problematika kryesore mbetet ende ngritja e strukturave për kontrollin e financimit të partive politike, caktimi i afateve të qarta të raportimit, detyrimi për regjistrimin e raporteve financiare të fushatave zgjedhore, publikimi i raporteve financiare, kufizimi i auditimit dhe kërkesave të raportimit në varësi të peshës së partive dhe thjeshtimi i raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit në mënyrë që auditorët financiarë dhe auditorët e KQZ-së të jenë përgjegjës vetëm për auditimin, e informacionit kyç.

4. Planifikimi, bashkërendimi dhe monitorimi i masave kundër korrupsionit

Në kuadër të bashkërendimit, është krijuar institucioni i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si institucioni që drejton përpjekjet e qeverisë për zbatimin e masave nënprioritetin 3. Gjithashtu, KKK-ja ka luajtur një rol kyç në krijimin e rrjetit të pikave të kontaktit në institucione, si dhe ka koordinuar politikën të rëndësishme si ndërmarrja e hapave që do t'i sigurojnë prokurorisë akses në bazat e të

dhënave të institucioneve të tjera. Por një koordinim, monitorim dhe zbatim i suksesshëm i masave kundër korrupsionit kërkon edhe rritjen e burimeve njerëzore dhe të kapaciteteve të tyre.

Në kuadrin e ndëshkimit evidentohen sfidat më poshtë:

Për sa i përket kuadrin ligjor kundër korrupsionit, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale gjatë 2014-s transferuan juridiksionin e çështjeve për korrupsion pasiv dhe aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve të drejtësisë, zyrtarëve të lartë të shtetit dhe të të zgjedhurve vendorë të Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Krimeve të Rënda. Ligji antimafia u ndryshua më 2014-n, gjithashtu, duke zgjeruar sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme që burojnë nga korrupsioni në të gjitha veprat penale që bien nën sferën e re të kompetencave të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Ligji për Policinë e Shtetit u ndryshua në shtator të 2014-s për të sanksionuar ngritjen e një Byroje Kombëtare të Hetimit, e ngarkuar me hetimin e çështjeve të korrupsionit.

Në vijim të këtyre ndryshimeve, si edhe të problematikave të evidentuara më parë, sfidat qëndrojnë ende të hetimi dhe ndjekja e korrupsionit. Disa nga problematikat e evidentuara nga projekti ACFA, si dhe nga misioni i PAMECA-s, kanë qenë sqarimi i juridiksioneve lidhur me zyrtarët e lartë, si dhe me imunitetet (në vijim të ndryshimeve ligjore), sqarimi dhe sigurimi i koordinimit të duhur qendror të hetimit të shkeljeve që lidhen me korrupsionin, duke siguruar koordinim mes ZPKR-së dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Gjithashtu, duhet të ndërmerren ndryshimet e nevojshme ligjore për të rritur efektivitetin e procedurave hetimore, si dhe dënimin e veprave të korrupsionit. Sfidë e rëndësishme mbetet mbështetja me burimet dhe kapacitetet e duhura për ndjekjen e korrupsionit, si pranë Prokurorisë ashtu edhe pranë NJPH-së. Roli i Shkollës së Magjistraturës dhe Qendrës së Formimit Policor në këtë proces është thelbësor.

Në kuadrin e ndërgjegjësimit evidentohen sfidat më poshtë:

Duke marrë parasysh që në këtë fushë aktorët që veprojnë janë të shumtë, qeveria duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të iniciuar fushata ndërgjegjësuese si për rëndësinë e luftimit të korrupsionit, ashtu edhe për rolin e qytetarëve. Më tej kjo përpjekje duhet të jetë e koordinuar dhe duhet që në aktivitetet dhe veprimtaritë e qeverisë të reflektohet rëndësinë e këtij prioriteti.

## KAPITULLI 2

### VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET E POLITIKAVE

#### **Vizioni**

*Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm*

Strategjia e re pasqyron drejtimit kryesor të programit qeveritar lidhur me luftën kundër korrupsionit, si dhe të dokumenteve strategjike për të ardhmen, siç ato pasqyrohen më poshtë.

Programi i qeverisë ka vendosur në kapitullin mbi antikorrupsionin, si dhe në fushat e lidhura me luftimin e tij, objektivat e mposhtëm:

- Intensifikimin e ndjeshëm në luftën kundër korrupsionit;
- Kalimin në sitë të legjislacionit ekzistues dhe propozimit të nismave ligjore për mënjanimin sa më të madh të mundësive për t'u angazhuar në praktika korruptive në sektorin publik dhe privat;
- Ndërmarrjen e nismave ligjore dhe përkrahje të zbatimit të masave që inkurajojnë njerëzit që denoncojnë korrupsionin;
- Zbatimin me përkushtim të legjislacionit dhe ndërmarrjen e nismave të reja lidhur me publikimin e dokumenteve zyrtare dhe transparencën në procedurat administrative;
- Rritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve publikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre;
- Mënjanimin e çdo ndikimi politik që ka shërbyer deri më sot për shikëmbime favoresh dhe influencash midis ekzekutivit dhe gjykatës;
- Përfshirjen në mënyrë të gjerë dhe të rëndësishme të shoqërisë civile, sektorit privat dhe atë akademik në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e nismave ligjore, strategjive dhe programeve kundër korrupsionit.

Për sa i përket parandalimit të korrupsionit, qëllimi i këtyre politikave është çrrënjosja e korrupsionit, së pari, nga radhët e administratës publike dhe të të gjitha segmenteve shtetërore dhe, kryesisht nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Në vijim të sfidave sa më lart, qëllimi parësor është forcimi i transparencës përmes zbatimit të legjislacionit përkatës në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore, rritja e transparencës lidhur me kontrollin dhe financimin e partive politike, si dhe forcimi i integritetit dhe i transparencës lidhur me zyrtarët publikë.

Për sa i përket ndëshkimit të korrupsionit, institucionet ligjzbatuese dhe, veçanërisht, ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore.

Specifikisht, në bazë të sfidave më lart, synohet rritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimit për hetimin e korrupsionit, si dhe marrja e masave për hetimet më efikase dhe efektive.

Ndryshime ligjore të nevojshme duhet të ndërmerren, gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të hetimeve, si dhe në kuadër të rritjeve të hetimeve proaktive dhe atyre me përdorimin e metodave speciale të hetimit. Shkëmbimi i informacionit duhet të përmirësohet, ndërsa organet ligjzbatuese duhet të kenë akses të mjaftueshëm dhe sa më të shpejtë në informacion.

Për sa i përket ndërgjegjësimit rreth korrupsionit, publiku duhet të marrë pjesë në luftimin e tij, duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativa që synojnë në parandalimin e fenomeneve korruptive.

Në afat të gjatë, korrupsioni i nivelit të ulët (*petty corruption*) nuk duhet të jetë prezent si një nga problematikat më të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve apo në perceptimin publik, ndërsa korrupsioni i zyrtarëve publikë dhe atyre të lartë duhet të dënohet sipas parashikimeve ligjore, duke evidentuar qartazi që ndëshkimi i ligjit aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë.

### KAPITULLI 3

#### OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE QËLLIMET MADHORE

Qëllimet madhore e kësaj strategjie janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

##### A. QASJA PARANDALUESE

Objektivat në kuadrin e qasjes parandaluese do të përfshijnë:

Objektivi A 1 - Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

Pjesëmarrja qytetare në procesin kompleks të qeverisjes është një domosdoshmëri dhe garanci për ruajtjen e integritetit të qeverisjes. Nga ana tjetër, transparenca në veprimtarinë shtetërore dhe aksesit i personave privatë (qytetarë dhe biznese) në informacionin e mbajtur nga qeveria është një kusht thelbësor për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, si dhe për mbrojtjen e interesave të tyre private.

Monitorimi i zbatimit të ligjit për aksesin në dokumente zyrtare ka nxjerrë në pah probleme serioze me natyrë ligjore dhe administrative, të cilat cenojnë aksesin e papenguar të qytetarëve në informacionin e mbajtur nga qeveria. Qasjet sektoriale e të gjitha institucioneve zbatuese të kësaj strategjie do të kushtojnë një vëmendje të madhe objektivit të transparencës. Ato do të zërthejnë në nivelin e sektorit këtë parim të rëndësishëm të qeverisjes demokratike përmes masave si më poshtë:

1. Zbatimi i parimeve të *Open Government* përmes krijimit dhe vënies në eficiencë të portalit qeveritar “Open Data”, si dhe shtimit të shërbimeve që ofrohen në rrugë elektronike;

2. Fuqizimi dhe vijimi i përdorimit të mjeteve elektronike që mundësojnë transparencë në administratën shtetërore, në sistemet e drejtësisë, në menaxhimin e integruar të informacionit për territorin etj.;

3. Zbatimi i plotë i ligjit për të drejtën e informimit, si dhe ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si mjet për transparencën e informacionit;

4. Pajisja e punonjësve të Policisë Rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera vëzhgimi



gjatë kryerjes së detyrave, për mjet kontrolli dhe transparence mbi veprimtarinë e punonjësve të Policisë;

5. Publikimi i rezultateve të inspektimeve, kontrolleve apo analizave të riskut të institucioneve;

6. Procese transparente të rekrutimit dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore në arsim dhe shërbimin civil;

7. Institucionalizimi i komunikimit dhe këshillimit me bashkësinë e biznesit dhe grupet e interesit në hartimin dhe miratimin e legjislacionit të fushave përkatëse, si dhe në shpërndarjen e informacionit për konsulencën dhe lehtësimin e biznesit.

Objektivi A 2 - Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore

Qeverisja e mirë mundësohet përmes vjeljes së detyrimeve të taksapaguesve dhe mirëpërdorimit të fondeve buxhetore. Tipikisht, keqadministrimi i fondeve buxhetore shkaktohet nga veprimi i faktorëve të ndryshëm korruptivë mbi institucionet publike që i përdorin ato. Për këtë arsye synohen:

1. Vlerësimi i performancës së prokurimeve publike në fusha me rrezik të lartë për korrupsion dhe marrja e masave për përjashtimin e subjekteve tregtare sipas legjislacionit në fuqi;

2. Botimi i informacioneve financiare me përparësi në fushën e mbrojtjes, koncesioneve, prokurimeve dhe të ardhurave të kompanive me kapital shtetëror;

3. Prokurime publike transparente dhe eficiente, përmes vlerësimit dhe matjes së performancës në bazë të treguesve konkretë dhe objektivë;

4. Rritja e kapaciteteve të strukturave të auditit lidhur me korrupsionin dhe parandalimin e tij.

Objektivi A 3 - Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike

Përmirësimi i faqeve zyrtare të internetit të institucioneve publike, duke i bërë ato ndëraktive, trajtimi elektronik i ankesave, shtimi i numrit të shërbimeve që jepen në mënyrë elektronike etj., kanë një ndikim të natyrshëm në luftën kundër korrupsionit. Në ndjekje të këtij objekti, qasjet sektoriale të institucioneve zbatuese të Strategjisë kanë premtuar zhvillime dhe zgjidhje me potencial të dukshëm antikorrupsion:

1. Zbatimi i Programit “Inovacioni kundër korrupsionit”, me qëllim modernizimin e shërbimeve publike, duke thjeshtuar, integruar procedurat dhe unifikuar ofrimin e shërbimeve në një qendër të vetme; digjitalizimi i informacionit të disponueshëm në fusha me rrezik të lartë për korrupsion dhe me ndikim të lartë në perceptimin e korrupsionit, përfshi këtu:

a) Shëndetësia lidhur me përdorimin e barnave;

b) Drejtësia lidhur me çështjet e delegimit me short;

c) Pronat ku parashikohet krijimi i gjeoportalit me informacion dhe akses në hartat që lidhen me pasuritë e paluajtshme dhe vlerat e tyre.

2. Digjitalizimi i sistemit të inspektimit në punë.

Objektivi A 4 - Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

Bashkëpunimi i punonjësve të brendshëm (*bilbilfryrësve*) të institucioneve publike dhe/ose private me agjencitë ligjzbatuese, si edhe të publikut është i një rëndësie jetike për hetimin e suksesshëm të veprave të korrupsionit. Shqipërisë i mungon kuadri i nevojshëm ligjor për të përfituar nga kjo formë bashkëpunimi.

Në kuadrin e përmirësimit të mekanizmave për mbrojtjen e bilbilfryrësve, si mjet për mbrojtjen e nëpunësve që tregojnë integritet të lartë dhe si mjet kontrolli i veprimtarisë shtetërore parashikohet:

1. Hartimi i kuadrit ligjor dhe të akteve nënligjore për të drejtat e bilbilfryrësve;

2. Krijimi i strukturave përgjegjëse brenda dhe jashtë institucioneve dhe fuqizimi i tyre për trajtimin e rasteve për trajtim.

Në kuadrin e përmirësimit të mekanizmave të trajtimit të denoncimeve nga publiku dhe të bashkëpunimit me synim rritjen e besimit ndaj strukturave shtetërore:

1. Krijimi i një qasjeje unike për trajtimin e rasteve të denoncuarra të korrupsionit nga publiku;

2. Rritja e besimit ndaj administratës përmes transparencës në trajtimin e denoncimeve dhe publikimin e të dhënave rreth trajtimit të tyre;

3. Dërgimi elektronik i ankesave dhe mundësimi i gjurmimit të shqyrtimit administrativ të ankesave nga qytetarët.

Objektivi A 5 - Forcimi i regjimit të deklarimit dhe të kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

Zbatimi me rigorozitet i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, si dhe masave për parandalimin dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit janë mjete të rëndësishme për kufizimin e korrupsionit. Monitorimi i zbatimit dhe analizat e ndryshme që i janë bërë ligjeve aktuale, për deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave, kanë nxjerrë në pah probleme serioze me natyrë ligjore dhe administrative, të cilat cenojnë efektivitetin e regjimit të kontrollit mbi zyrtarët publikë. Konsiderohen shumë të rëndësishme aktivitetet si më poshtë:

1. Ndryshimet ligjore të harmonizuara lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve me qëllim përmirësimin e procesit të deklarimit dhe të kontrollit të pasurive;
2. Zbatimi i rekomandimeve të GRECO-s/ Këshillit të Evropës lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave;
3. Mundësimi i deklarimeve *online* të pasurisë për të gjitha subjektet deklaruese dhe publikimi i deklaratave të interesave private pa kërkesë;
4. Ndryshimet ligjore të harmonizuara lidhur me parandalimin e trajtimin e konfliktit të interesave dhe krijimi dhe funksionalizimi i regjistrit elektronik të konfliktit të interesave;
5. Akte nënligjore të miratuara që detajojnë kërkesat e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave për fusha të rëndësishme dhe komplekse për korrupsionin, si koncesionet dhe partneritetet publike-private;
6. Rritja e kapaciteteve të strukturave të administratës/autoriteteve përgjegjëse për të zbuluar, trajtuar dhe zgjidhur konfliktin e interesave.

Objektivi A 6 - Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

Integriteti i partive politike është parakusht thelbësor për integritetin e qeverisjes dhe parandalimin e korrupsionit. Integriteti i partive rrezikohet më së shumti nga financimet e paligjshme. Në këto kushte, është e një rëndësie jetike për luftën kundër korrupsionit që Shqipëria të forcojë regjimin e kontrolleve mbi financimin e partive politike. Ky objektivi i Strategjisë përkon plotësisht me fushën e veprimtarisë së një institucioni të pavarur që është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

1. Propozimi dhe hartimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor lidhur me përdorimin e burimeve apo fondeve publike gjatë fushatave zgjedhore;
2. Miratimi i akteve ligjore dhe/ose nënligjore për të mundësuar lehtësimin e procedurave të auditimit të financimit të partive politike;
3. Marrja e masave për krijimin dhe rritjen e kapaciteteve të strukturave përkatëse në KQZ për kontrollin dhe verifikimin e raporteve të auditeve;
4. Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuere për blerjen e votave, si dhe për evitimin e aferave korruptive për arsye politike gjatë fushatave zgjedhore.

Objektivi A 7 - Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

Auditimi dhe inspektimi i brendshëm administrativ shpesh nxjerr në pah probleme të natyrës strukturore, procedurale dhe etike, të cilat, po të mos eliminohen, krijojnë një terren të përshtatshëm për korrupsionin. Më tej, analizat e riskut janë një risi për administratën publike shqiptare, të parashikuara përmes ndryshimeve të fundit legjislativë, dhe duke njohur potencialin e kësaj metode për të parandaluar fenomene korruptive, qeveria ka zgjedhur ta bëjë përdorimin sistematik të analizave të riskut një objektivi kryesor të Strategjisë kundër Korrupsionit 2015 – 2020. Synohet që përmes kësaj strategjie të kryhen:

1. Rishikimi i kuadrit ligjor për inspektimin financiar publik me qëllim funksionimin efektiv të tij;
2. Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të auditit të brendshëm, si dhe rritja e cilësisë së auditit si struktura që parandalojnë korrupsionin;
3. Reformimi i sistemit të inspektimit në fushën e drejtësisë me fokusin në gjykata dhe Prokurori;
4. Inspektime elektronike dhe koordinimi përmes Inspektoratit Qendror për parandalimin e korrupsionit në inspektime;
5. Forcimi i monitorimit dhe i kontrollit të ekzekutimit të kontratave të prokurimit publik.

Objektivi A 8 - Përdorimi sistematik i evidentimit të hapësirave për korrupsion (*corruption proofing of legislation*)

Shpesh korrupsioni mundësohet që në fazën e hartimit të ligjeve ose të akteve nënligjore. Parashikimi i procedurave komplekse për marrjen e një shërbimi, parashikimi i përgjegjësive dhe roleve të mbivendosura, parashikimi i afateve të gjata dhe të paarsyeshme etj., janë vetëm disa shembuj sesi ligjet ose aktet nënligjore mund të bëhen shkas për korrupsion në sektorë të ndryshëm të qeverisjes. Në këto kushte është e një rëndësie thelbësore për luftën kundër korrupsionit që të gjitha institucionet publike që hartojnë ligje dhe akte nënligjore të adaptojnë dhe të përdorin një metodologji për vlerësimin e hapësirave korruptive (*corruption proofing of legislation*).

Ashtu si analizat e riskut, edhe vlerësimi i hapësirave korruptive (*corruption proofing of legislation*) është një risi për administratën publike shqiptare. Duke njohur potencialin e kësaj metode në luftën kundër korrupsionit, qeveria ka zgjedhur ta bëjë përdorimin sistematik të saj një objektivi kryesor të Strategjisë kundër Korrupsionit 2015–2017:

1. Përfshirja e Manualit për evidentimin e hapësirave për korrupsion të hartuar nga PACA-ja në manualin e rishikuar për hartimin e legjislacionit;

2. Rritja e kapaciteteve të strukturave për të kryer vlerësimin e hapësirave për korrupsion.

Objektivi A 9 - Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë

Ndershmëria dhe integriteti i individëve, të cilët punësohen në sektorin publik është parakusht për parandalimin e korrupsionit. Në këto kushte, është vendimtare që në disa sektorë të qeverisjes, të cilët janë të prirur për korrupsion (p.sh.: polici, prokurime, tatime, gjyqësor etj.), sektorët e personelit të adaptojnë dhe të zbatojnë metodologji për të testuar paraprakisht integritetin e kandidatëve për këto vende pune dhe në vijimësi integritetin e punonjësve. Aktivitetet afatgjatë janë:

1. Rekrutimi në administratën publike i individëve me integritet të lartë;

2. Forcimi i integritetit të zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe reduktimi i korrupsionit;

3. Rritja e kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e sistemeve të testimit të integritetit.

Objektivi A 10 - Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

Korrupsioni si fenomen priret të jetë dinamik në kuptimin që ai shfaqet një herë në një sektor dhe një herë në një sektor tjetër, në varësi së pranisë së kushteve të tilla favorizuese, si mungesa e transparencës, mungesa e një mekanizmi për të dëgjuar zërin e subjekteve të interesuara, mungesa e procedurave të qarta administrative dhe procedurave të ankimit etj. Në këto kushte edhe përgjigja ndaj korrupsionit duhet të jetë dinamike. Ky dinamizëm sigurohet nëpërmjet analizimit sistematik të prirjeve të korrupsionit, analizimit sistematik të efektivitetit të masave antikorrupsion, analizimit të statistikave të konsoliduara të qeverisë, por edhe të organeve ligjzbatuese lidhur me korrupsionin. Konsolidimi i statistikave ka qenë një prioritet për Shqipërinë, i theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga BE-ja gjatë 10 viteve të fundit. Është e rëndësishme që të dhënat statistikore të jenë të koordinuara midis të gjitha agjencive ligjzbatuese dhe të evidentojnë qartë fakte, të tilla si: numri i hetimeve, numri i gjykimeve, numri dhe masa e dënimeve, burimet e kallëzimeve penale, fushat e rasteve të kallëzuara dhe të dënuara etj. Objektivi specifik synon në:

1. Rritja e kapaciteteve të njëjësive të ndryshme të kuadrit kundër korrupsionit në Shqipëri;

2. Krijimi i një sistemi të konsoliduar të dhënash (*track rekord*) lidhur me regjistrimin e hetimeve të krimit të organizuar, krimit financiar dhe korrupsionit;

3. Ndërtimi i sistemeve që mundësojnë analizimin e statistikave në organet ligjzbatuese, përfshi këtu sistemet e menaxhimit të çështjeve;

4. Rritja e kapaciteteve të personelit të organeve ligjzbatuese mbi raportimin statistikor dhe analizimin e të dhënave statistikore të rasteve të korrupsionit;

5. Ndërlidhja e sistemeve të ndryshme elektronike për komunikimin e saktë të statistikave.

Objektivi A 11 - Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore

Është e rëndësishme që institucionet e pushtetit vendor të përfshihen në programin antikorrupsion të qeverisë, duke adaptuar objektivat dhe politikat e lartpërmendur duke i përshtatur ata me specifikat e pushtetit vendor:

1. Krijimi i *one stop shop* në nivel vendor për ofrimin e shërbimeve dhe/ose lehtësimi i procedurave për marrjen e shërbimeve;

2. Krijimi i faqeve *web* të përditësuara dhe publikimi i të dhënave në çdo njësi i buxheteve dhe i shpenzimeve të çdo bashkie;

3. Ofrimi i praktikave më të mira njësvite të reja të qeverisjes vendore lidhur me menaxhimin dhe raportimin e financave;

4. Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe të vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal.

## B. QASJA NDËSHKIMORE

Objektivat në kuadrin e qasjes ndëshkimore do të përfshijnë:

Objektivi B 1 - Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

Hetimi penal i krimit ekonomik dhe financiar duhet të jetë i shpejtë (provat që vërtetojnë kryerjen e këtyre krimeve janë veçanërisht të prirura për t'u zhdukur) dhe i aftë për të vërtetuar deri në detaj dy gjëra: a) fajësinë; dhe b) pasurimin e paligjshëm të të dyshuarve.

Për ta bërë këtë, agjencitë ligjzbatuese duhet të jenë në gjendje të përdorin mjetet speciale të hetimit (përgjime, vëzhgime etj.), të kryejnë hetime të plota financiare dhe të përfitojnë nga bashkëpunimi i shumë institucioneve publike dhe private. Për këtë arsye, aktivitetet e sugjeruara në këtë kuadër janë:

1. Rritja e numrit të operacioneve ku përdoren teknika speciale të hetimit dhe atyre proaktive dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të organeve ligjzbatuese;

2. Rritja e operacioneve në fushën e korrupsionit;

3. Përdorimi dhe menaxhimi më i mirë i informacionit për hetimin e korrupsionit;

4. Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit;

5. Garantimi i qëndrueshmërisë të OPGJ-së dhe zyrtarëve të organeve ligjzbatuese.

Objektivi B 2 - Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

Ndërsa hetimi dhe ndëshkimi i një krimi të zakonshëm zakonisht përfshin trion polici, prokurori dhe gjyqësor, hetimi i suksesshëm i krimit ekonomik përfshin një gamë më të gjerë aktorësh, si: ILDKP-ja, KLSH-ja, DPPPP-ja, subjekte private, si: bankat, firmat e ndërtimit, agjencitë e pasurive të patundshme, agjencitë e udhëtimit etj., etj. Bashkëpunimi i frutshëm midis organeve të hetimit dhe gjithë këtyre subjekteve është një parakusht për suksesin e luftës penale kundër korrupsionit. Këtu përfshihen:

1. Qartësimi i kuadrit të bashkëpunimit midis strukturave të ndryshme ligjzbatuese (administrativ, penal) për rritjen e efikasitetit të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit;

2. Mundësimi i aksesit elektronik permanent të organeve ligjzbatuese në databaza shtetërore dhe/ose shtrirja e mëtejshme e aksesit për të mundësuar shkëmbimin më efikas dhe të shpejtë të informacionit gjatë hetimeve;

3. Analizimi i prirjeve të korrupsionit;

4. Shkëmbim informacioni ndërmjet organeve ligjzbatuese mbi denoncimet për korrupsion, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit për fusha me rendësi të veçantë, si: drejtësia, shëndetësia, pasuritë e paluajtshme etj., me synim menaxhimin më të mirë të informacionit për hetimin e korrupsionit.

Objektivi B 3 - Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

Kuadri ligjor për ndjekjen penale të korrupsionit duhet t'i përgjigjet në vazhdimësi prirjeve të korrupsionit dhe problematikës së evidentuar nga hetimi dhe ndëshkimi i kësaj forme të kriminalitetit.

1. Ka nevojë, në kuadër edhe të reformës në drejtësi, për analizimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor si më poshtë, me synim harmonizimin e procesit të hetimeve dhe procedimeve penale:

a) Kodin e Procedurës Penale;

b) Ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë;

c) Ligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike (dhe komunikimet elektronike nëse vlerësohet e nevojshme);

d) Ligjin mbi bashkëpunimin e publikut kundër korrupsionit.

2. Amendimet duhet të kenë si synim të përmirësojnë kushtet për hetimin e korrupsionit përfshi këtu:
- i) afatet e hetimeve paraprake;
  - ii) përdorimin e përgjimeve;
  - iii) përdorimin e provave në çështje korrupsioni.

Objektivi B 4 - Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar

Të ardhurat nga krimi ekonomik dhe financiar shpesh depozitohen ose investohen jashtë vendit. Në këto kushte është e një rëndësie vendimtare që organet ligjzbatuese të bashkëpunojnë me kundërpalët e tyre në vendet e huaja, sidomos për kryerjen e hetimit financiar.

Nën këtë objektiv, qasjet sektoriale e vënë theksin te nevoja për trajnime specifike dhe forcimin e lidhjeve me autoritetet simotra të vendeve të huaja.

### C. QASJA NDËRGJEGJËSUESE

Objektivat në kuadrin e qasjes ndërgjegjësuere do të përfshijnë:

Objektivit C 1 – Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

Bashkëpunimi i publikut në luftën kundër korrupsionit është një domosdoshmëri. Për të siguruar këtë bashkëpunim, institucionet përgjegjëse duhet të bëjnë të mundur sensibilizimin e publikut për pasojat negative të korrupsionit mbi jetën e çdo anëtar individual të shoqërisë.

1. Mjete ndërgjegjësimi për korrupsionin janë përfshirë në kurrikula shkollorë të edukimit në vazhdim;
2. Realizimi i fushatave kombëtare kundër korrupsionit;
3. Realizimi i fushatës lidhur me denoncimin nga informatorët/bilbilfryrësit (*whistleblowers*);
4. Trajnime të zyrtarëve në lidhje me zbatimin e ligjit për informatorët e rasteve të korrupsionit/bilbilfryrësit;

5. Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere për përdorimin e sistemeve të ndryshme që shmangin korrupsionin.

Objektivit C 2 - Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit

Nxitja e publikut për përdorimin e mekanizmave dhe sistemeve të ankesave është një nga instrumentet më efikase në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i besimit se këta mekanizma funksionojnë realisht do të ndikojë në rritjen e numrit të ankesave dhe denoncimeve duke ndikuar kështu pozitivisht në efikasitetin e luftës kundër korrupsionit.

1. Krijimi i mjeteve elektronike për denoncimin e korrupsionit;
2. Publikimi *online* i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet;
3. Raportimi publik mbi rastet e trajtuara të korrupsionit.

Objektivit C 3 - Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile

Përgjatë këtyre viteve të fundit shoqëria civile në Shqipëri ka zhvilluar ekspertizë të një niveli të lartë në lidhje me teknikat dhe metodat e hartimit dhe monitorimit të masave kundër korrupsionit. Për këtë arsye, përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile në procesin e konceptimit dhe, çka është më e rëndësishme, mundësimi i saj për të monitoruar ecurinë në zbatimin e masave antikorrupsion nga qeveria është shumë e rëndësishme. Partneriteti me shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit do të ngrihet në nivelin e duhur dhe do të forcohet jo vetëm përmes përfshirjes së tyre për dhënien e mendimeve, por dhe gjatë proceseve vendimmarrëse. Ky partneritet do të fuqizohet më tej përmes takimeve konsultative.

1. Rishikimi i kuadrit ligjor mbi bashkëpunimin e publikut për denoncimin e rasteve të korrupsionit;
2. Fuqizimi i bashkëpunimit të institucioneve të pavarura me median;
3. Përmirësimi i konsultimit gjatë hartimit dhe vlerësimit të politikave kundër korrupsionit.

## KAPITULLI 4

### BURIMET FINANCIARE

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë

produktet e planit të veprimit trevjeçar, 2015-2017 në zbatim të Strategjisë. Kostot e zbatimit të masave konkrete janë paraqitur nga secila ministri apo institucion përgjegjës për zbatimin e tyre.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2015-2017, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Është synuar që nëpërmjet këtij procesi të evitohen mbivendosjet financiare në dokumentet strategjike. Plani i Veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe e Planit të Veprimit është 1,730,727,309.60 lekë, ose 12,362,337.93 euro.


Qasja parandaluese pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e planit, përkatësisht në masën 57%. Ndërsa qasja ndëshkimore dhe ndërgjegjësuere peshojnë përkatësisht 32% dhe 11% në totalin e buxhetit të planit të veprimit.

Qasjet e Strategjisë	Kostoja totale potenciale	Burimet e financimit			
		Buxheti i shtetit	IPA (EU)	Donatorë të tjerë	Hendeku financiar
A. QASJA PARANDALUESE	986,706,634.60	372,174,714.60	170,240,000.00	268,619,000.00	175,672,920.00
B. QASJA NDËSHKIMORE	548,090,432.00	477,791,000.00	-	-	70,299,432.00
C. QASJA NDËRGJEGJËSUESE	195,930,243.00	1,080,000.00	-	48,970,243.00	145,880,000.00
<b>TOTAL</b>	<b>1,730,727,309.60</b>	<b>851,045,714.60</b>	<b>170,240,000.00</b>	<b>317,589,243.00</b>	<b>391,852,352.00</b>
<b>Ekivalent në EURO</b>	<b>12,362,337.93</b>	<b>6,078,897.96</b>	<b>1,216,000.00</b>	<b>2,268,494.59</b>	<b>2,798,945.37</b>

Financimi i planit të veprimit të strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e komunitetit të donatorëve. Buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 49% të financimit të nevojshëm. Ndërsa pjesa tjetër pritet të financohet nga Bashkimi Evropian dhe nga donatorët (Banka Botërore, UNDP, OSBE, “Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion” me 16% dhe objektivit A.3 “Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike” me 14%.

USAID, OPDAT etj.). Në momentin e hartimit të planit të veprimit hendeku financiar vlerësohet të jetë në masën 23% të totalit.

Peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet e nevojshme për zbatimin masave në kuadër të objektivit B.1 “Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit” me 30%, objektivit A.1



Objektivat	Kostoja totale potenciale	Në % (objektivi / Totali)
A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	270,969,657.60	<b>16%</b>

A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	5,300,000.00	0%
A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	238,036,667.00	14%
A. 4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	151,800,000.00	9%
A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	109,717,390.00	6%
A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	2,275,000.00	0%
A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	33,174,320.00	2%
A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	739,680.00	0%
A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	10,080,000.00	1%
A.10 Analizimi i prijeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit.	164,613,920.00	10%
A.11 Artikulimi dhe adaptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	-	0%
B. 1 Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	524,024,432.00	30%
B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit	13,874,000.00	1%
B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	6,216,000.00	0%
B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	3,976,000.00	0%
C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	154,280,000.00	9%
C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	40,040,000.00	2%
C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile	1,610,243.00	0%
<b>TOTAL</b>	<b>1,730,727,309.60</b>	<b>100%</b>

Plani i veprimit të strategjisë do të rishikohet në bazë vjetore për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform ciklit të programimit vjetor buxhetor, si dhe prioritetëve të çdo sektori. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave do të identifikojë me komunitetin e donatorëve mundësitë për mbështetje financiare të nevojshme për ato masa, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara financiarisht.

## KAPITULLI 5

### LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

#### Institucionet zbatuese

Zbatimi i Strategjisë do të realizohet përmes koordinimit të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, njëkohësisht KKK-së dhe përmes raportimit të tij në qeveri.

Në këtë rol, në vijim të miratimit të strategjisë kundër korrupsionit 2015-2017, KKK-ja do të iniciojë ngritjen e një mekanizmi mbikëqyrës dhe zbatues për strategjinë kundër korrupsionit. Mekanizmi i koordinimit dhe mbikëqyrjes ka si qëllim dhe detyrë koordinimin e punës për zbatimin e strategjisë, përmes zhvillimit të mëtejshëm dhe miratimit të planit të veprimit, monitorimit të zbatimit të planit të veprimit dhe raportimit publik mbi progresin e zbatimit të tij. Mekanizmi do të mbështetet nga një sekretariat teknik, ndërsa në rolin e tij si drejtues i këtij mekanizmit, KKK-ja do të kërkojë kontributin e të gjitha institucioneve të përfshira në strategji për monitorimin e saj.

Në mbështetje të procesit të monitorimit, KKK-ja do të ketë përgjegjësinë të përdorë të gjitha platformat e mundshme për komunikimin dhe përfshirjen e institucioneve të pavarura dhe të shoqërisë civile në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.

#### Treguesit e përgjithshëm dhe synimet e Strategjisë

Përshkrimi i treguesit	Baseline/ pikat kryesore	Synimi për 2017	Synimi për 2020
<b>Indeksi i perceptimit të korrupsionit</b>	Sipas matjes të indeksit (0-100, ku 0 përkon me nivel të lartë korrupsioni, dhe 100 përkon me nivel të ulët korrupsioni) Shqipëria ka indeksin <b>33</b>	<b>37.5</b> (Rritje prej 1.5-2.5 pikësh çdo vit)	<b>40.5</b> (Rritje prej 1.5-2.5 pikësh çdo vit)
<b>Kontrolli i korrupsionit, Banka Botërore</b>	Indikator i përbërë i cili mat gjendjen e korrupsionit dhe evidenton përqindjen e vendeve që janë nën atë performancë Shqipëria renditet më mirë se <b>25.84%</b> e vendeve të tjera që vlerësohen	Shqipëria performon më mirë se 34% e vendeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin	Shqipëria performon më mirë se 40% e vendeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin
<b>Studimi mbi performancën e mjedisit të sipërmarrjes dhe të investimeve, Banka Botërore</b>	Si në studimin e 2005, ashtu edhe të 2008, korrupsioni ishte pengesë e rëndësishme për biznesin (renditur i <b>dyti</b> në rëndësi)	Korrupsioni nuk përbën një nga 3 pengesat më të rëndësishme për biznesin	Korrupsioni nuk përbën një nga 4 pengesat më të rëndësishme për biznesin
<b>Raport i Nations in Transit</b>	Vlerësimi për situatën e korrupsionit në Shqipëri është <b>5.25</b> (ku 1=shumë mirë, 7= shumë keq) Mesatarja e vlerësimeve për vendet e BE-së është <b>3.43</b> , ndërsa për vendet e Ballkanit <b>4.79</b>	Vlerësimi për Shqipërinë është <b>4.5</b>	Vlerësimi për Shqipërinë është <b>4.2</b>
<b>Rekomandimet e GRECO për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit në radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe parlamentarëve</b>	10 rekomandime janë dhënë për Shqipërinë në raundin e 4-t të vlerësimeve, më 2014	Të gjitha rekomandimet e raundit të 4-t janë zbatuar plotësisht	Të gjitha rekomandimet e raundit të 5-t janë zbatuar plotësisht

#### Treguesit specifikë

Duke marrë parasysh natyrën ndërsektoriale të këtij dokumenti, është vendosur që indikatorët specifikë të kësaj fushe të përqendrohen në treguesit si më poshtë:

- përbushja e treguesve specifikë, të caktuar për çdo masë sipas Planit të veprimit që i bashkëngjitet kësaj strategjie;
- numri i hetimeve dhe i operacioneve proaktive dhe atyre me metoda speciale hetimi;
- numri i kallëzimeve penale për vepra korrupsioni sipas metodologjisë për statistika të konsoliduara;
- numri i dënimeve për vepra penale të korrupsionit.

Raportimi periodik, metodologjia e raportimit dhe raportimet publike

Objektivat e mekanizmit koordinues, si dhe të monitorimit janë identifikimi i progresit të arritur për zbatimin e strategjisë, identifikimin dhe korrigjimin e problematikave të zbatimit të strategjisë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me nevojën e zbatimit të masave.

KKK-ja do të organizojë takime koordinuese çdo 3 (tre) muaj, si dhe çdo 6 (gjashtë) muaj për një analizë më të thelluar të problematikave të hasura.

Gjithashtu, një takim duhet të organizohet çdo vit në dhjetor, në ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit. Çdo tremujor, sekretariati teknik do të hartojë raporte të përmbledhura monitorimi, të cilat



do të vlerësohen në vijim nga mekanizmi monitorues. Raportet e përgatitura do të publikohen, gjithashtu, për të mundësuar aksesin dhe dhënien e informacionit ndaj palëve të interesuara, ndërsa në bazë 6-(gjashtë) mujore do të mbahen takime ku do të diskutohen raportet e monitorimit që janë hartuar nga sekretariati teknik dhe të publikuara për konsultim, të cilat do t'i prezantohen për miratim mekanizmit monitorues. Plani i veprimit do të jetë një dokument që do të ndryshojë dhe do të përditësohet nga mekanizmi koordinues çdo vit, me synim arritjen e objektivave të strategjisë.

Sekretariati teknik, me mbështetjen e institucioneve të përfaqësuara në mekanizmin monitorues, si dhe me anë të kontributit të institucioneve të pavarura dhe të palëve me të cilat KKK-ja ka krijuar platforma bashkëpunimi, përmbush aktivitetet si më poshtë për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë:

- a) mbledh projektraportet e monitorimit e institucioneve;
- b) shqyrton projektraportet e veprimit të dorëzuara nga institucionet për zbatimin dhe rekomandon në përputhje me rrethanat, miratimin e tyre, ndryshimin apo testimin;
- c) pas përditësimit të planit të veprimit, harton planin e integruar;
- d) u komunikon institucioneve vendimet e mekanizmit monitorues së bashku me udhëzimet e lëna nga ky i fundit;
- e) harton raportin e zbatimit të integruar;
- f) u komunikon publikut vendimet e marra dhe dokumentet e miratuara.

Në aspektin cilësor të monitorimit, sekretariati teknik mund të sugjerojë ose mund t'i caktohet nga mekanizmi koordinues të përdorë metodat e mëposhtme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë:

- a) përditësimin e përmbushjes apo jo të masave për parandalimin e korrupsionit, sipas planit të veprimit (aneks 1) dhe në bazë të vetëvlerësimit të institucioneve;
- b) vlerësime tematike, sipas udhëzimeve të mekanizmit vlerësues, lidhur me efektivitetin e veprimeve të ndërmarra;
- c) përdorimin e analizës statistikore apo cilësore, duke përdorur të dhëna krahasuese përtej atyre të vetëraportimeve të institucioneve;
- d) përdorimin e raporteve të tjera nga Kombet e Bashkuara, GRECO-ja, OECD-ja etj., që lidhen me vlerësimin e situatës të luftës kundër korrupsionit;
- e) komunikimin me palë të treta dhe shoqërinë civile për vlerësimin e masave të zbatuara;
- f) dokumentimin e arritjeve dhe të praktikave të mira;
- g) përdorimin e metodave të tjera vlerësuese, përfshi këtu sondazhe, vlerësime situatë, pyetësorë etj.

Mjetet dhe mënyrat me të cilat do të raportohet, si p.sh.: formularë, sisteme/programe elektronike komunikimi të informacionit etj., do të ofrohen nga sekretariati teknik dhe do të miratohen nga mekanizmi koordinues gjatë takimit të parë të mekanizmit koordinues. Mjetet dhe mënyrat e raportimit mund të rishikohen dhe të miratohen të përditësuara nga mekanizmi koordinues.

Raportet e monitorimit duhet të publikohen në bazë vjetore dhe gjerësisht, duke raportuar gjithmonë arritjet, mangësitë në zbatim, si dhe rekomandimet e dhëna për institucionet nga mekanizmi koordinues. Në përfundim të afatit të strategjisë, një raport vlerësimi do të hartohet lidhur jo vetëm me zbatimin e strategjisë gjatë gjithë kohës së zbatimit të saj, por edhe lidhur me impaktin që strategjia ka pasur për arritjen e objektivave dhe vizionit të strategjisë. Ky raport mund të hartohet me asistencën e palëve të treta, sipas vendimit të mekanizmit koordinues, por gjithmonë në përputhje me urdhrin nr. 139, të Kryeministrit, "Për zbatimin e procesit të monitorimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale". Në këtë raport do të pasqyrohet shkalla e arritjes së indikatorëve vit pas viti.

ANEKS 1

PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2017

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	A. 1.1	Finalizimi i regjistrimit themeltar të vendimmarrjes së kthimit dhe kompensimit	1. Numri i vendimeve të regjistruara dhe numri i të dhënave, duke marrë parasysh mbrojtjen e privatësisë të individëve dhe subjekteve; 2. Numri i subjekteve të interesuara që kanë vizituar regjistrin	drejtësi	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP)		maj 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 1.2	Rekrutimi i punonjësve mësimorë sipas profilit përkatës dhe në bazë të meritës e preferencës	1. Nisma “Mësues për Shqipërinë”; 2. Testimi në bazë DAR/ZA-je dhe profili; 3. Ndërtimi i bazës së të dhënave për pjesëmarrjen dhe klasifikimin e tyre (rankimi) Identifikimi dhe shpallja në vijimësi e vendeve të lira në portal	arsim	Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS)	DAR/ZA-të Shkollat	2015 - 2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.3	Vlerësimi vjetor i mësuesve në bazë performace	Unifikimi i treguesve të performancës duke krijuar një formular të standardizuar	arsim	Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS)	DAR/ZA-të	2015 - 2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.4	Vlerësim teknik i sistemit të integritetit akademik në arsimin e lartë dhe vlerësimi i aplikimit të një sistemi elektronik për kontrollin e plagjiaturës	Vlerësimet e kryera së bashku me kostimin përkatës	arsim	Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS)	Universitetet	2016-2017	3,220,000.00	<b>3,220,000.00</b>
	A. 1.5	Publikimi në faqen e DPM-së të emrave të subjekteve të autorizuara për kryerjen e shërbimeve metrologjike	1. Publikimi në faqen e DPM-së i emrave të subjekteve të autorizuara për kryerjen e shërbimeve metrologjike; 2. Nr. i subjekteve në listë; 3. Aksesit online; 4. Raporte periodike publike mbi shërbimet e dhëna nga subjekti 5. Vlerësim risku lidhur me shërbimet e	ekonomi	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM)	MZHETS	Dhjetor 2015/2016/2017		<b>376,300.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
			metrologjisë dhe subjektet që i ofrojnë						
	A. 1.6	Hartimi dhe publikimi i manualeve standarde për procedurat e koncesioneve	1. Publikimi dhe aksesimi i manualeve në faqen web; 2. Nr. i personave të trajnuar lidhur me manualin; 3. Nr. i takimeve me palët e interesuara lidhur; 4. Shpërndarja pranë palëve të interesuara dhe institucioneve; 5. Nr. i personave të trajnuar lidhur me manualin; 6. Nr. i takimeve me palët e interesuara lidhur me manualin	ekonomi	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATK)	MZHETS	Korrik 2015		<b>800,000.00</b>
	A. 1.7	Pajisja e punonjësve të policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera vëzhgimi gjatë kryerjes së detyrave	1. Raporti i Policisë së Shtetit për rastet abuzive të Policisë Rrugore; 2. Nr. total i automjeteve të pajisura; 3. Regjistri i prokurimit të kamerave	rend	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)		Dhjetor 2015		<b>84,000,000.00</b>
	A. 1.8	Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve publike	Raportet publike në faqen internet të Ministrisë	ekonomi	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS)		çdo tre muaj 2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.9	Hartimi i programeve të transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit	1. Publikimi i programeve të transparencës në faqet zyrtare të ministrive në internet; 2. Raporte monitorimi nga shoqëria civile; 3. Nr. i iniciativave të papërbushura sipas programit; 4. Raporti vjetor i KDIMDP-së në Kuvend lidhur me të drejtën e informimit dhe programet e transparencës	të gjitha	Të gjitha ministrinë	KDIMDP	1 maj 2015	pa kosto shtesë	-

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
	A. 1.10	Krijimi i strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit	1. Krijimi i strukturave pranë KDIMDP-së; 2. Caktimi i personave pranë të gjitha institucioneve për zbatimin e ligjit	administratë	KDIMDP-ja		2015-2016	9,600,057.60	<b>9,600,057.60</b>
	A. 1.11	Instalimi i sistemit audio në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë	1. Nr. i gjykatave me sistem audiofunksional; 2. Niveli i përdorimit nga gjykatat	drejtësi	MD-ja		dhjetor 2015		<b>53,000,000.00</b>
	A. 1.12	Publikimi i dëgjësave dhe i vendimeve në përfundim të procedurave paraprake për vlerësimin e ndikimit në mjedis	1. Numri i dëgjësave publike; 2. Numri dhe lista e pjesëmarrësve në dëgjesa; 3. Vendimet e aksesueshme në faqen web; 4. Raportet vjetore të Agjencisë	mjedis	Ministria e Mjedisit (MM)	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	çdo tre muaj 2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.13	Bërja publike e raporteve të monitorimit për ndikimin në mjedis të projekteve dhe e numrit të ankesave nga publiku	1. Raportet dhe ankesat të aksesueshme në faqen web; 2. Nr. i ankesave të trajtuara; 3. Nr. i raporteve të trajtuara	mjedis	Ministria e Mjedisit (MM)		çdo janar 2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.14	Pasqyrimi i tarifave të çdo shërbimi në QSUT	1. Adresa web me informacionin përkatës; 2. Lista e tarifave në QSUT; 3. Nr. i ankesave të marra për mosrespektim të tarifave	shëndetësi	Ministria e Shëndetësisë (MSH)		korrik 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 1.15	Mirëmbajtja e Regjistrit të Zhvillimit të Territorit në lidhje me sigurinë e hedhjes së të dhënave, nga përdoruesit e ndryshëm dhe përditësimi i saj	Vlerësimi aksesueshmërisë dhe i botimeve	zhvillim urban	AKPT-ja		2015	pa kosto shtesë	-
	A. 1.16	Përmirësimi i metodologjisë për përcaktimin e kategorive në fushën e licencimit profesional të pasurive të paluajtshme (studim, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim)	1. Dokumenti i vlerësimit; 2. Dokumenti i rishikuar	zhvillim urban	MZHU-ja		2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.17	Aksesi në portalin online <i>e-Inspektimi</i>	Portal i aksesueshëm	inovacion	Inspektorati Qendror (IQ)	Inspektoratet shtetërore (pilate)	maj 2015		<b>9,450,000.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
	A. 1.18	Publikimi i kriterëve dhe i kushteve të përcaktuara në VKM “Për testimin dhe rekrutimin e inspektorëve”	Publikimi pas miratimit të VKM-së	të gjitha	Inspektorati Qendror (IQ)		2015	pa kosto shtesë	-
	A. 1.19	Transparencë për alokimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA	1. Materiali i lidhur me kushtet, afatet dhe kriteret e aplikimit i publikuar; 2. Nr. i aplikimeve dhe i fituesve i publikuar në faqe	ekonomi	AIDA		çdo vit	pa kosto shtesë	-
	A. 1.20	Transparencë në fondet që alokohen për projektet kulturore	1. Informacioni i publikuar online lidhur me kushtet, kriteret dhe afatet për aplikime; 2. Nr. i aplikimeve dhe i fituesve; 3. Publikimi i projekteve fituese dhe raportet e vlerësimit të projekteve të publikuara online	kulturë	Ministria e Kulturës (MK)		çdo vit	pa kosto shtesë	-
	A. 1.21	Publikimi online i komponentëve të Shërbimit Këshillimor Publik (Ekstensioni Bujqësor)	1. Publikimi online i treguesve të monitorimit dhe i vlerësimeve të punës së shërbimit; 2. Publikimi online i emrave të specialistëve dhe profileve të tyre, si dhe të të dhënave të kontaktit për çdo specialist; 3. Publikimi online i të gjitha trajnimeve dhe aktiviteteve sipas çdo rrethi; 4. Publikimi i emrave të të gjithë përfituesve nga Shërbimi Këshillimor Publik dhe përfituesit e granteve iPARD-it që janë këshilluar nga SHKP-ja	bujqësi	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)		dhjetor 2015		<b>99,000.00</b>
	A. 1.22	Krijimi në QSUT i Qendrës së Informimit të Publikut	1. Numri i shërbimeve të ofruara; 2. Regjistri i shërbimeve; 3. Numri i përfituesve të shërbimit	shëndetësi	Ministria e Shëndetësisë (MSH)		2015	18,000,000.00	<b>18,000,000.00</b>
	A. 1.23	Publikimi periodik i projekteve, përfshirë edhe fondin, aktivitetet, si edhe vendet vakante dhe kriteret e konkurimit për çdo projekt të financuar nga donatorë	1. Aktivitetet dhe shpenzimet e projektit të publikuara në faqen zyrtare; 2. Raporti narrativ dhe financiar i zbatimit të projektit publikuar në faqen zyrtare	sociale	MMSR-ja		2015-2017	pa kosto shtesë	-

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
	A. 1.24	Publikimi në faqen e internetit të MZHU-së i emrave dhe subjekteve që disponojnë licenca në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, si dhe licenca profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme	1. Faqja e internetit është e aksesueshme prej të gjithë qytetarëve dhe subjekteve të interesuara 2. Faqja vazhdimisht në përditësim dhe plotësim	zhvillim urban	MZHU-ja	Institucione të varësisë	2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 1.25	Publikimi në faqen e internetit të MZHU-së i dokumentacionit të plotë për aplikim për licenca në fushën e studim e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, si dhe licenca profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme	1. Faqja e internetit është e aksesueshme prej të gjithë qytetarëve dhe subjekteve të interesuara 2. Faqja vazhdimisht në përditësim dhe plotësim	zhvillim urban	MZHU-ja		2015-2018	pa kosto shtesë	-
	A. 1.26	Krijimi i një aplikacioni për AKPT-në dhe Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe hartën GIS të tij	1. Akses i plotë në aplikacion 2. Nr. i rasteve të shkëmbimit të informacionit	zhvillim urban	AKPT-ja		2015-2016		<b>20,000,000.00</b>
	A. 1.27	Analizimi dhe raportimi publik i rezultateve nga "Formulari i klientit" dhe rubrika "Sondazh", që përdoren nga blerësit (subjektet) e standardeve.	Publikimi i të dhënave nga sondazhi	ekonomi	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit		në mënyrë periodike 6-mujore		<b>300,000.00</b>
	A. 1.28	Zbatimi i "Sistemit për qeverisjen e hapur, njoftimin dhe konsultimin publik" nëpërmjet moduleve: 1-moduli informues mbi partneritetin për qeverisjen e hapur (PQH-OGP) 2-moduli për njoftimin dhe	1. Nr. i vizitorëve të faqes; 3.Të dhënat e ofruara dhe formatet e aksesueshme të të dhënave	të gjitha	AKSHI	te gjitha institucionet	2015		<b>72,124,300.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
		konsultimin publik 3-moduli "Open Data" për transparencë mbi aktivitetin e institucioneve publike							
	A. 1.29	Zbatim i plotë i ligjit për konsultimin publik	Nr. i akteve të miratuara për të cilat është kryer procesi i konsultimit sipas dispozitave përkatëse	drejtësi	Të gjitha institucionet, institucioni përgjegjës (sipas akteve nënligjore)		në bazë vjetore	pa kosto shtesë	-
<b>A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion</b>									<b>270,969,657.60</b>
A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	A. 2.1	Përgatitja dhe botimi i një udhëzimi për përdorimin e fondeve buxhetore dhe natyrën e mbajtjes së llogarive në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit	1. Adresa web e aksesueshme me udhëzimin; 2. Raportet publike në format të aksesueshëm të shpenzimeve sipas çdo përfaqësie diplomatike	çështje të jashtme	MPJ-ja		2015	pa kosto shtesë	-
	A. 2.2	Hartimi dhe miratimi me akt ligjor ose nënligjor i modaliteteve dhe kriterëve të përcaktuara për mënyrën e kthimit të garancive financiare të investimit të subjekteve private	1. Aktet e rregulluara të publikuara; 2. Raportim mbi vlerën totale të kthyer të garancive financiare; 3. Publikimi i emrave të kompanive që nuk kanë kryer investimet përkatëse	ekonomi	AKBN-ja	Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)	mars 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 2.3	Hartimi i listës së zezë së kompanive që kryejnë projektimin, konsultim, zbatim projektesh në fushën e transportit	1. Publikimi i listës; 2. Njoftimi i APP-së; 3. Publikimi i kriterëve, si dhe i vlerësimit të çdo kompanie (përcaktimi i metodologjisë së ponderuar të indikatorëve të performancës, si më poshtë vijon: - cilësia; përgjigjja dhe gatishmëria; përmbushja e detyrimeve; përfundimi në kohë; organizimi; përshtatshmëria, gatishmëria, vazhdimësia; përshtatshmëria	transport	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)		2015	pa kosto shtesë	-

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
			dhe rendimenti; zgjedhja e duhur; mënyra e paraqitjes së dokumenteve/kërkesave; paraqitja e dosjes përfundimtare; përputhshmëria me çdo detyrim)						
	A. 2.4	Aplikimi për pajisjen me certifikatën e pronësisë të të gjitha pronave në administrim të Forcave të Armatosura	1. Regjistri i certifikatave të pronësisë; 2. Vlerësim i publikuar i përdorimit të pronave në administrim të FA-së	mbrojtje	Ministria e Mbrojtjes (MB)		dhjetor 2016	pa kosto shtesë	-
	A. 2.5	Botimi i dokumenteve për shpenzimet e mbrojtjes në kuadër të konventave të OKB-së dhe OSBE-së për kontrollin e armëve	Analiza e shpenzimeve të mbrojtjes e publikuar me link-un përkatës	mbrojtje	Ministria e Mbrojtjes (MB)		çdo vit	pa kosto shtesë	-
	A. 2.6	Vënia në funksionim e sistemit të pikësimit për vlerësimin e kompanive që marrin pjesë në fondin e punësimit	1. Formula e pikësimit e publikuar (link); 2. Aksesi online në thirrjen për aplikime; 3. Publikimi i kriterëve dhe i përfituesve të fondit	sociale	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)		janar 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 2.7	Bërja publike e buxhetit dhe e procedurave të prokurimit publik në web siten e institucionit	1. Bërja publike e buxhetit të institucionit dhe të procedurave të prokurimit publik; 2. Publikimi i kompanive fituese të proceseve të prokurimit	drejtësi	Avokati i Popullit (AP)		në vazhdimësi	pa kosto shtesë	-
	A. 2.8	Përgatitja e treguesve për matjen e performancës së autoriteteve kontraktore, në fushën e prokurimit	Manuali i treguesve të performancës në prokurime	ekonomi	APP-ja		qershor 2016		<b>5,300,000.00</b>
	A. 2.9	Trajnimi i të ngarkuarve me financë në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit, në lidhje me evidentimin dhe regjistrimin e	1. Numri i personave të trajnuar; 2. Moduli i trajnimit; 3. Agjenda e takimit	çështje të jashtme	MPJ-ja		mars 2015	pa kosto shtesë	-



Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
		shpenzimeve, si dhe me njohjen e kuadrit ligjor të përditësuar							
	A. 2.10	Rishikimi i kuadrit ligjor me qëllim rritjen e transparencës për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik	VKM-ja e miratuar në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi proceset e prokurimit dhe shpenzimet e mallrave të prokuruar	mbrojtje	Ministria e Mbrojtjes (MB)		dhjetor 2015	pa kosto shtesë	-
<b>A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike</b>									<b>5,300,000.00</b>
A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	A. 3.1	Shtimi i shërbimeve në portalin e-Albania	1. Numri i shërbimeve të ofruara; 2. Numri i shikueshmërisë së faqes; a) Gjatë vitit 2015 do të shtohen edhe 90 shërbime të tjera të ofruara plotësisht online (nivelet 3-4), sipas kategorizimit të BE-së	inovacion	AKSHI		2015		<b>116,666,667.00</b>
	A. 3.2	Krijimi i qendrave të ofrimeve të shërbimeve si sportel unik	1. Inventarizimi i shërbimeve aktuale; 2. Identifikimi i shërbimeve parësore për t'u ofruar; 3. Adaptimi i modifikimeve të nevojshme ligjore për ofrimin e shërbimeve në formë elektronike; 4. Ngritja e Qendrës për Ofrimin e Shërbimeve në Modelin "one stop shop"	inovacion	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP)	Kryeministria / (DAETIK, Delivery Unit) ADISA	2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 3.3	Gjurmimi i barit që nga prodhimi dhe tregtimi deri të përdoruesi final përmes sistemit elektronik Track and Trace	1. Raporti i projektit për pilotimin në Durrës; 2 Linku që mundëson hyrjen në sistemin Track and Trace; 3. Raporte vlerësimi për funksionimin e sistemin dhe gjurmimin	shëndetësi	Ministria e Shëndetësisë (MSH)		qershor 2015	1,400,000.00	<b>1,400,000.00</b>
	A. 3.4	Digjitalizimi i të dhënave të treguesve të stacioneve të furnizimit të naftës e të gazit (sh.a. e sh.p.k.) si faza e parë për paraqitjen e treguesve dhe kushteve	1. Lista e treguesve energjetikë; 2. Përqindja e të dhënave që janë digjitalizuar	ekonomi	Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)	Inspektorati Qendror Teknik (IQT)	dhjetor 2016		<b>10,000,000.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
		teknike e ligjore							
	A. 3.5	Digjitalizimi i fondit të të dhënave gjeologo-gjeofizike dhe arshivës teknike të operacioneve hidrokarbure për kompanitë e interesuara në fushën e kërkimit dhe zhvillimit të hidrokarbureve	1. Aksesi i mundësuar (link); 2. Përqindja e të dhënave të hedhura në sistem	ekonomi	AKBN-ja		2015	pa kosto shtesë	-
	A. 3.6	Hartimi i projektit për krijimin e hartës unike të vendimmarrjes	Projekti i hartuar, së bashku me kostimin e tij	drejtësi	AKSHI	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP)	dhjetor 2017 (1 vit nga livrimi i fondit)	pa kosto shtesë	-
	A. 3.7	Krijimi i gjeoportalit me informacion dhe akses të saktë në hartat topografike, ortofoto, hartat e kufirit, hartat treguese të pasurive të paluajtshme dhe harta të vlerave të pronës	1. Website i aksesueshëm; 2. Numri i shërbimeve të ofruara; 3. Numri i kërkesave për informacion të pranuar; 4. Nr. i hartave të hedhura në sistemin digjital	inovacion	MIAP-ja	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor (ASIG)	dhjetor 2015		<b>4,900,000.00</b>
	A. 3.8	Krijimi i sistemit elektronik për përcaktimin me short të mënyrës së delegimit të gjyqtarëve	1. Sistemi elektronik funksional; 2. Nr. i ankesave për zhvillimin e shortit; 3. Vlerësimet (nëse ka) lidhur me sistemin elektronik	drejtësi	KLD-ja		2016		<b>800,000.00</b>
	A. 3.9	Krijimi në web i bazës së të dhënave për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara	1. Faqja web; 2. Aksesi në regjistrin e publikuar; 3. Analizë krahasimore lidhur me këto vepra dhe trendet e pasurive të administruara	financë	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)		dhjetor 2015	28,000,000.00	<b>28,000,000.00</b>
	A. 3.10	Hartimi i kuadrit ligjor për pajisjen e targave me Cip dhe vënia në funksion të lejeve të qarkullimit me Cip	1. Hartimi i akteve ligjore përkatëse për pajisjen e targave me Cip; 2. Nr. i mjeteve të pajisura me Cip	transport	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)		2015-2017	pa kosto shtesë	-
	A. 3.11	E-Egzaminime (Sistemi i menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara	Softi dhe sistemi i instaluar	shëndetësi	FZHR-ja	MSH-ja	2015		<b>57,720,000.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
		mjekësore)							
	A. 3.12	Inspektimi me kite portabel nga inspektoratet pilote	Portali e-Inspektimi	të gjitha	Inspektorati Qendror (IQ)	Inspektoratet shtetërore (ISHPSHSH; ISHSH; ISHM; AKU)	maj 2015		<b>18,550,000.00</b>
<b>A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike</b>									<b>238,036,667.00</b>
A. 4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	A. 4.1	Hartimi dhe miratimi i projektligjit për informatorët e rasteve të korrupsionit dhe mbrojtjen e tyre (bilbilfryrësit) nga Këshilli i Ministrave	1. Vlerësimi i situatës para hartimit të ligjit 2. Projektligji i publikuar në QPZ	antikorrupsion	MSHÇV-ja	Ministria e Drejtësisë (MD)	qershor 2015		<b>14,000,000.00</b>
	A. 4.2	Zbatimi i ligjit dhe fushata sensibilizuese	Design i fushatës; hartimi i akteve nënligjore, mjetet e informimit (spots, reklama etj.)	antikorrupsion	MSHÇV-ja		qershor 2016		<b>28,000,000.00</b>
	A. 4.3	Analiza e vlerësimit të situatës lidhur me ligjin e bilbilfryrësve	Dokumenti i analizës	antikorrupsion	MSHÇV-ja		2015	28,000,000.00	<b>28,000,000.00</b>
	A. 4.4	Përpilimi dhe miratimi i akteve nënligjore nga të gjitha institucionet që ngarkohen me zbatimin e ligjit për bilbilfryrësit	1. Vlerësimi i nevojave për zbatimin e ligjit; 2. Aktet nënligjore të miratuara	të gjitha	Të gjitha institucionet publike		prill 2015	9,380,000.00	<b>9,380,000.00</b>
	A. 4.5	Hartimi i draft formularëve dhe mjeteve të denoncimit për institucionet zbatuese	Formularët e hartuar dhe të shpërndarë pranë institucioneve	antikorrupsion	MSHÇV-ja		dhjetor 2015	2,170,000.00	<b>2,170,000.00</b>
	A. 4.6	Rritja e burimeve njerëzore në ILDKPKI	1. Buxheti i miratuar; 2. Nr. i personave të punësuar	administratë	ILDKPKI-ja		janar 2016	32,256,000.00	<b>32,256,000.00</b>
	A. 4.7	Rritja e kapaciteteve të stafit të ILDKPKI-së	Nr. i trajnimeve dhe personave të trajnuar	administratë	ILDKPKI-ja		dhjetor 2016 e çdo vit	784,000.00	<b>784,000.00</b>
	A. 4.8	Hartimi i akteve nënligjore dhe i formularëve për raportimin	Akte nënligjore të hartuara dhe formularët e publikuar	të gjitha	ILDKPKI-ja	MD-ja, MSHCV-ja	dhjetor 2015		<b>2,800,000.00</b>

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
	A. 4.9	Fuqizimi i rolit të ILDKPKI-së për zbatimin e ligjit për bilbilfryrësit	1. Asistencë Teknike pranë ILDKPKI-së; 2. Seanca trajnimi në punë; 3. Nr. i vizitave studimore	të gjitha	ILDKPKI-ja	MD-ja, MSHCV-ja	qershor 2016		<b>8,400,000.00</b>
	A. 4.10	Trajnimi i zyrtarëve pranë ASPA-së	1. Hartimi i moduleve të trajnimit; 2. Nr. i të trajnuerve; 3. Nr. i trajnimeve	të gjitha	ILDKPKI-ja	MD-ja, MSHCV-ja	mars 2016		<b>1,400,000.00</b>
	A. 4.11	Zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve lidhur me raportimin	1. Nr. i trajnimeve; 2. Nr. i të trajnuarve	të gjitha	ILDKPKI-ja	MD-ja, MSHCV-ja	prill 2016		<b>4,200,000.00</b>
	A. 4.12	Krijimi dhe funksionimi i strukturave që do të trajtojnë çështjet e informatorëve të rasteve të korrupsionit	Rregulloret e brendshme të miratuara dhe strukturat e miratuara	të gjitha	Të gjitha institucionet publike		shkurt 2016	pa kosto shtesë	-
	A. 4.13	Ngritja e kapaciteteve e njëjësive që do trajtojnë rastet dhe përfshirja në kurrikulat e trajnimit nga ana e SH.M dhe Shkolla e Policisë, përmes <i>Training of Trainers</i> .	1. Nr. i trajnimeve; 2. Nr. i personave të trajnuar	administratë	Të gjitha institucionet ligjzbatuese		qershor 2017	pa kosto shtesë	-
	A. 4.14	Integrimi i tematikave dhe ligjit të ri në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës dhe Policisë, përmes <i>training of trainers</i>	1. Sesionet e trajnimeve; 2. kurrikulat e përgatitura; 3. Nr. i <i>trainers</i> të trajnuar	administratë	SHM-ja	Akademia e Policisë	2017	3,010,000.00	<b>3,010,000.00</b>
	A. 4.15	Monitorim proaktiv dhe i vazhdueshëm i medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, si dhe pritja dhe zgjidhja në kohë e ankesave/ rasteve/ informacioneve të denoncuar	1. Nr. i denoncimeve nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, si dhe rrjeteve sociale; 2. Nr. i denoncimeve në linjën jeshile, por edhe të gjitha portat e komunikimit e shërbimit me publikun; 3. Raporti i publikuar për këto raste dhe ndjekja e tyre	rend	Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)		gjate vitit 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 4.16	Përmirësimi i infrastrukturës për pritjen e publikut	Zyra e re për pritjen e publikut; Nr. i qytetarëve të pritur; Pajisja e zyrës me mjetet e nevojshme	rend	Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)		dhjetor 2015	pa kosto shtesë	-

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
	A. 4.17	Krijimi i strukturës së shqyrtimit dhe apelimit të ankesave brenda AKBN-së, ose në funksion të miratimit të ndryshimeve të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”	1. Raporti i ankesave dhe analizës (adresa web ku është i aksesueshëm). 2. Regjistri i ankesave. 3. Numri i ankesave dhe apelimeve; 4. Rregullorja për shqyrtimin e ankesave.	ekonomi	AKBN	Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (MEI)	dhjetor 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 4.18	Raportimi i statusit të kohës reale të dhënies së shërbimeve	1. Procedurat të hartuara dhe të miratuara; 2. Raport i vlerësimit me: 732 000 shërbime të realizuara në kohë për vitin 2014, 747 000 shërbime realizuara në kohë për vitin 2015 dhe 762 000 shërbime të realizuara në kohë për vitin 2016	drejtësi	Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)		2017	pa kosto shtesë	-
	A. 4.19	Hartimi i urdhrit të KM-së për rregulloren e funksionimit të portalit të antikorrupsionit	1. Urdhri i aksesueshëm në faqen zyrtare të KM-së dhe MSHÇV-së në internet; 2. Funksionimi i rrjetit të zyrtarëve përgjegjës; 3. Përqindja e ankesave të trajtuara sipas afateve	antikorrupsion	MSHÇV-ja	Këshilli i Ministrave	mars 2015	pa kosto shtesë	-
	A. 4.20	Konceptimi i një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin e publikut mbi procedurat e reja për denoncimin e korrupsionit	Publikimi i mjeteve të fushatës	antikorrupsion	MSHÇV-ja		qershor 2015		<b>11,200,000.00</b>
	A. 4.21	Funksionalizimi i faqes unike elektronike për trajtimin e denoncuar të korrupsionit	1. Nr. i ankesave të trajtuara; 2. Nr. i çështjeve që kanë shërbyer si indicie për fillimin e hetimeve administrative dhe/ose procedimeve penale; 3. Emërimi i rrjetit të personave që trajtojnë ankesat; 4. Raportime mujore mbi ecurinë e rasteve; 5. Publikim i buletinit mujor; 6. Publikim i statistikave; 7. Rritja e kapaciteteve të Zyrës Operative	antikorrupsion	MSHÇV-ja	AKSHI, institucionet e përfshira në projekt	shkurt 2015		<b>6,200,000.00</b>
	A. 4.22	Krijimi i strukturave inspektuese në nivel DAR;	Ngritja e sektorit në inspektimit në DAR	arsim	MAS-i		2015-2016	pa kosto shtesë	-

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Sektori	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kostoja e vlerësuar e produktit	Totali
